

REZYME

Zhvillimi i leksikut policor në gjuhën shqipe është përcjellë historikisht nën ndikimin e sistemit ideopolitik të administrimit të shtetit shqiptar nga 1912 e këtej. Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimit të shtetit shqiptar, si datë e krijimit të *forcave të rendit* apo të *xhandarmërisë (policisë) shqiptare* është data 13 janar 1913. Termet e policisë së shtetit shqiptar dallojnë me kalimin e kohës sipas ngjarjeve historike dhe kalimit të dy luftërave botërore, si: *Milicia Shqiptare, Xhandarmëria dhe Milicia, Kavaleria, aspirantë dhe xhandarë, Ministria e Luftës, Ministria e Punëve të Brendshme, Arma e Gjindarmërisë Mbretnore, inspektor i përgjithshëm i Gjindarmërisë, Komanda e Përgjithshme e Gjindarmërisë, komisar i policisë, gjindarmëria shëtitëse, gjindarmëria qytetëse, Arma e Karabinierisë Mbretnore, karabinieri, nënkuestori, agjenti i sigurimit, komanda qarqesh, komanda rrethesh, komanda postash etj.*, të gjithë këta terma të policisë së shtetit shqiptar i gjejmë nga 1913 deri 1944, kur edhe përfundon Lufta e Dytë Botërore. Në këto terme policore vërehet ndikimet e sistemit italian, si: *Kavaleria, Karabinieria, nënkuestori, aspiranti etj.*

Në Kosovë për shkak të ngjarjeve historike, zhvillimi i leksikut policor ka qenë i varur kryesisht nga sistemi jugosllav i qeverisjes, ose i serbokroatishtes, e cila ishte gjuhë zyrtare mbizotëruese ndaj gjuhëve të tjera, si sllovenishtja, maqedonishtja, shqipja dhe hungarishtja. Ndër termet policore në gjuhën shqipe nga vitet 1970-1990 në kohën e ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës veçojmë: *Sekretariati i Punëve të Brendshme, milicia, postat e milicisë, njësitë e specializuara të milicisë, postat e milicisë së komunikacionit, aradha e milicisë, milicioner, inspektor i lartë, inspektor i pavarur, inspektor kryesor, kryeshf i Drejtoratit për Sigurim Publik, shërbimi vrojtës, sigurimi i brezit kufitar, laboratoriumet për ekspertiza kriminalistike, postkomandant etj.* Ndërsa në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe në sistemin komunist shqiptar gjejmë terme dhe nocione të policisë të ideologjizuara nga sistemi i lindjes – kryesisht nga ndikimi rus dhe jugosllav, si: *Policia Popullore, Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, ndjekja e kundërshtarëve politikë, organi informativ, ndikimi i proletariatit, parimet marksiste-leniniste etj.* Në Kosovë më 6 shtator 1999 krijohet *Shërbimi Policor i Kosovës* me ndihmën e OSBE-së dhe Misionit të UNMIK-ut, i cili administroi Kosovën deri më 2008, kur u shpall shteti i pavarur. Ndër termet policore të cilat i veçojmë në Kosovë nga viti 1999 e këtej janë: *Shërbimi Policor i Kosovës, polic,*

zyrtar policor, Policia Kufitare, Komandant i Stacionit Policor, Komandant Regjional i Policisë, rreshter, toger, kapiten, major, nënkolonel, kolonel, forenzikë, hetuesi, operativë, komesari i policisë, drejtori i përgjithshëm i policisë, drejtori rajonal i policisë, Policia e Kosovës, lufta kundër krimit të organizuar, kundër terrorizmit, luftimi i trafikimit me njerëz, kundër narkotikëve, krimeve kibernetike etj. Në Shqipëri ndryshojnë termet policore pas përfundimit të sistemit komunist më 1990 e këtej, e që po i veçojmë disa nga termet policore të cilat shpeshherë dallojnë nga termet policore të Kosovës si: Policia e rendit, Ministria e Rendit Publik, Policia e Shtetit, Ministria e Brendshme, policimi në komunitet, menaxhimi i integruar i kufirit, komesariati i policisë, policia rrugore, drejtoria vendore e policisë, posta e policisë, punonjës i policisë, nënkomisar, komisar, kryekomisar, drejtues, drejtues i parë, drejtues i lartë, drejtues madhor etj. Pra, dukuria e sinonimisë në leksikun terminologjik policor është mjaft e shprehur ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Si gjuhë ndikuese në terminologjinë policore janë identifikuar më së shumti gjuha serbe dhe angleze në Kosovë, si dhe italishtja dhe anglishtja në Shqipëri. Mënyra e fjalëformimit të leksikut policor në përgjithësi është realizuar nëpërmjet ndajshitesimit (parashtesimit dhe prapashtesimit) dhe kompozitave. Ndër to veçojmë: nënkomisar, nënkolonel, policim, policor, arrestim, zëvendëskomandant, kryeshef, kryekomisar, pengmarrës, vendvrojtim, rrethkomandë etj.

Vjelja e leksikut policor në gjuhën shqipe është realizuar si kapitull i veçantë i këtij punimi disertacioni sipas rendit alfabetik, (ndoshta edhe kreu më i rëndësishëm i këtij disertacioni dhe i pari i këtij lloji deri më tani në gjuhën shqipe) me qëllim të krijimit të një fjalori për nevoja të policisë, i cili nuk është i kufizuar vetëm me terme të drejtpërdrejta policore, por që ndërliiden drejtpërdrejt edhe me termat juridikë, administrativë, ekonomikë, kriminalistikë, politikë, ushtarakë dhe të sigurisë në përgjithësi.

Fjalët kyçe: zhvillimi i leksikut policor, ndikimi ideo-politik, fjalëformimi, sinonimet, ndikimi i serbishtes, italishtes dhe anglishtes.

SUMMARY

Development of police lexicon in Albanian language has historically depended on ideological and political system of administration of Albania from 1912 and onwards. After declaration of independence of Albania and establishment of Albania as a state, 13 January 1913 is the date when Albanian *public order force (forcat e rendit)* or *gendarmerie (xhandarmëria) - police* was created. Terminology used in the police force of Albania differs throughout time and historical events, including two world wars: *Milicia Shqiptare, Xhandarmëria dhe Milicia, Kavaleria, aspirantë dhe xhandarë, Ministria e Luftës, Ministria e Punëve të Brendshme, Arma e Gjindarmërisë Mbretnore, inspektor i përgjithshëm i Gjindarmërisë, Komanda e Përgjithshme e Gjindarmërisë, komisari i policisë, gjindarmëria shëtitëse, gjindarmëria qytetëse, Arma e Karabinierisë Mbretnore, karabinieri, nënkuestori, agjenti i sigurimit, komanda qarqesh, komanda rrethesh, komanda postash, etc.*

All these police terms of Albanian State Police are found between 1913 and 1944, when the Second World War ended. In these police terms it is noticeable influence by Italian system, with terms like: *Kavaleria, Karabinieria, nënkuestori, aspirant, etc.*

In Kosovo, as a result of historic events, development of police lexicon depended mainly on Yugoslav system of government, or Serbo-Croatian which was the official language that dominated more than other languages: *Slovenian, Macedonian, Albanian and Hungarian*. Among the police terms in Albanian language in the time period 1970 – 1990 in the time of ex-Socialist Autonomous Province of Kosovo, we can highlight the following terms: *Sekretariati i Punëve të Brendshme, milicia, postat e milicisë, njësitë e specializuara të milicisë, postat e milicisë së komunikacionit, aradha e milicisë, milicioner, inspektor i lartë, inspektor i pavarur, inspektor kryesor, kryeshef i Drejtoratit për Sigurim Publik, shërbimi vrojtës, sigurimi i brezit kufitar, laboratoriumet për ekspertiza kriminalistike, postkomandant, etc.*

On the other side, in Albania, during this time period in the Albanian communist system there was in use police terminology and notions based on east ideological system – with Russian and Yugoslav influence, like: *Policia Popullore, Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, ndjekja e kundërshtarëve politikë, organi informativ, ndikimi i proletariatit, parimet marksiste-leniniste, etc.*

On September 06, 1999, in Kosovo, it was created Kosovo Police Service (*Shërbimi Policor i Kosovës*) with the assistance by OSCE and UNMIK Mission, which administrated Kosovo until 2008 when Kosovo declared its independence. Some of the police terms which we can highlight after 1999 are as following: *Shërbimi Policor i Kosovës, polic, zyrtar policor, Policia Kufitare, Komandant i Stacionit Policor, Komandant Regjional i Policisë, rreshter, toger, kapiten, major, nënkolonel, kolonel, forenzikë, hetuesi, operativë, komesari i policisë, drejtori i përgjithshëm i policisë, drejtori rajonal i policisë, Policia e Kosovës, lufta kundër krimit të organizuar, kundër terrorizmit, luftimi i trafikimit me njerëz, kundër narkotikëve, krimeve kibernetike, etc.*

In Albania there was a change in police terminology when the communist system collapsed in 1990 and onwards. Some of the terms, which are quite different from those used in Kosovo police, are as following: *Policia e rendit, Ministria e Rendit Publik, Policia e Shtetit, Ministria e Brendshme, policimi në komunitet, menaxhimi i integruar i kufirit, komesariati i policisë, policia rrugore, drejtoria vendore e policisë, posta e policisë, punonjës i policisë, nënkomisar, komisar, kryekomisar, drejtues, drejtues i parë, drejtues i lartë, drejtues madhor, etc.*

Therefore, phenomenon of great synonymy in police terminology lexicon between Kosovo and Albania is evident. *Serbian* and *English* were identified as influential languages in police terminology in Kosovo, whereas in Albania *Italian* and *English*. The word formation of police lexicon in general it was realized through affixation (prefixes and suffixes) and composites. Among these, we can highlight: *nënkomisar, nënkolonel, policim, policor, arrestim, zëvendëskomandant, kryeshëf, kryekomisar, pengmarrës, vendvrojtim, rrethkomandë, etc.*

Collection of police lexicon was realized as a separate chapter of this dissertation paper based on alphabetical order (which may be the most important chapter of this dissertation and the first of its kind in Albanian language) with the intention to create a dictionary for the needs of police. This dictionary would not be limited only to direct police terminology, but also with *judicial, administrative, economic, penal, political, military and security* terminology in general.

Key words: *development of police lexicon, ideological political influence, word formation, synonyms, influence of Serbian, Italian and English.*